



# RAPORTI I PËRPUTHSHMËRISË SË MONITORIMIT TË PERFORMANCËS NË NIVEL BASHKIE

**DHJETOR 2020**



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

**Publikuar nga:**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
Drejtoria e Financave Vendore  
Tiranë, Tetor 2019

**Kontribues në Raportin e Përputhshmërisë**

**të Monitorimit të Performancës në Nivel Bashkie:**

Prof. As. Dr. Fran Brahimi, Prof. Dr. Stefan Pfaeffli,  
MSc. Elidona Durmishi, MSc. Mariel Frroku,  
MSc. Almira Ferraj

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë falenderon për kontributin e tyre:**

Ministrinë e Punëve të Brendshme, Projektin “Bashki të Forta”,  
Projektin “Financat Lokale”, INSTAT/SALSTAT

**Ky raport mundësohet nga:**

“Bashki të Forta”

**Copyright ©**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ky raport nuk mund të riprodhohet, shpërndahet apo transmetohet në asnjë format, duke përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo metoda të tjera elektronike, pa lejen e shkruar të autorit, përveç rasteve të referencave në botime të tjera dhe përdorimit jo-komercial sikurse parashikuar në ligjin për të drejtat e autorit.

Ky projekt është inicuar dhe financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, dhe zbatohet nga Helvetas.

**RAPORTI  
I PËRPUTHSHMËRISË  
SË MONITORIMIT  
TË PERFORMANCËS  
NË NIVEL BASHKIE  
DHJETOR 2020**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE  
DHE EKONOMISË

---

# Lista e Shkurtimeve

---

GMS	Grupi për Menaxhimin Strategjik
IPF	Instrument i Planifikimit Financiar
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PB	Programet e Buxhetit
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PFA	Planifikimi Financiar Afatmesëm
RM	Raport Monitorimi
RMZB	Raportet e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit
TP	Tregues Performance



---

# Tabela e Përmbajtjes

---

PARATHËNIE	7
1. HYRJE	9
2. METODOLOGJIA	10
3. PËRPUTHSHMËRIA ME KRITERET E RAPORTIMIT	16
3.1. REZULTATET SIPAS BASHKISË	16
4. REKOMANDIME	42

---

# Lista e Tabelave

---

Tabela 1: Lista e 36 programeve të paraqitura nga MFE-ja për pushtetin vendor	<b>11</b>
Tabela 2: Shembuj të qëllimeve dhe të objektivave të një programi	<b>11</b>
Tabela 3: Kriteret e vlerësimit dhe përmasa e kampionit	<b>14</b>
Tabela 4: Metoda e përdorur për elementet e vlerësuara në mënyrë cilësore	<b>14</b>
Tabela 5: Ndryshimi në krahasim me 2018	<b>15</b>
Tabela 6: Pikëzimi i përputhshmërisë	<b>15</b>
Tabela 7: Grupi i bashkive me përputhshmëri më të lartë me kërkesat e udhëzimit	<b>40</b>

---

# Lista e Figurave

---

Figura 1: Programet me frekucë më të lartë të treguesve të performancës	12
Grafiku 1. Treguesit më të përdorur në RZMB 2019	29

---

# Lista e Hartave

---

Harta 1: Bashkitë që kanë dorëzuar një Raport Monitorimi në vitin 2019	<b>17</b>
Harta 2: Klasifikimi i shpenzimeve sipas programeve në vitin 2019	<b>19</b>
Harta 3: Të njëjtat programe të raportuara në RMZB-në e vitit 2019 dhe PBA-në 2019-2021	<b>21</b>
Harta 4: Klasifikimi i shpenzimeve sipas aktivitetit ekonomik në vitin 2019	<b>23</b>
Harta 5: Raportimi për investimet kryesore të vitit 2019	<b>25</b>
Harta 6: Përdorimi i treguesve të performancës në dokumentet e RMZB-së në vitin 2019.	<b>27</b>
Harta 7: Raportimi i treguesve financiarë të vitit 2019	<b>31</b>
Harta 8: Raportimi i të ardhurave sipas burimit në vitin 2019	<b>33</b>
Harta 9: Raportimi i të ardhurave të planifikuara kundrejt atyre të realizuara në vitin 2019	<b>35</b>
Harta 10: Përdorimi i raportit në Këshillat Bashkiake 2019	<b>37</b>
Harta 11: Vendosja e RMZB-së 2019 në web	<b>39</b>
Harta 12: Renditja e përputhshmërisë së RMZB-së në vitin 2019 me kuadrin ligjor	<b>41</b>

---

# Parathënie

---

Gjatë viteve të fundit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka bërë reforma të rëndësishme të cilat kanë rritur dhe përmirësuar kuadrin rregullator për burimet e financimit të njësive të vetëqeverisjes vendore. Kjo është shoqëruar me thellim të procesit të decentralizimit jo vetëm në drejtim të përdorimit të burimeve financiare por edhe të kompetencave dhe funksioneve që njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë. Gjatë kësaj kohe është vënë një fokus i rëndësishëm në rritjen e autonomisë fiskale e financiare të vetëqeverisjes vendore, si një nga elementët kryesorë e të domosdoshëm për forcimin e qeverisjes dhe demokracisë vendore.

Në fund të vitit 2019 është rishikuar strategjia për Menaxhimin e Financave Publike për periudhën 2019-2022, ku janë përcaktuar objektiva strategjike në drejtim të rritjes së efektshmërisë dhe efikasitetit të menaxhimit financiar në nivel vendor. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë përgjegjëse për një numër funksionesh të përcaktuara sipas legjislacionit për pushtetin vendor. Financat e pushtetit vendor aktualisht përfaqësojnë 9.8 përqind të shpenzimeve totale publike në të njëjtën kohë kur kapacitetet e NJVQV-ve për të menaxhuar fondet publike shpesh janë të dobëta, duke sjellë shpenzime jo-efikase dhe mungesë transparence. Për më tepër, parashikimi i dobët i të ardhurave dhe performanca e dobët për mbledhjen e të ardhurave nga burimet e veta, mungesa e planifikimit në planin afatmesëm dhe afatgjatë

si dhe rritja e detyrimeve të prapambetura, janë fusha të tjera që ngrenë shqetësime të cilat do të trajtohen nga MFE-ja.

Në drejtim të monitorimit të performancës së shpenzimeve publike të realizuara në nivel vendor, viti 2020 është viti i dytë i prodhimit të këtij raporti kombëtar për monitorimin e zbatimit të buxhetit mbi bazë performance. Në mbështetje të trendit historik të krijuar në vitin e kaluar, nëpërmjet këtij raporti synojmë identifikimin e problematikave dhe arritjeve gjatë procesit të monitorimit në dy vitet e shkuara dhe objektivave të viteve të ardhshme.

Forcimi i planifikimit strategjik dhe rritja e rolit të menaxhimit të buxhetit mbi bazë performance nga njësitë e vetëqeverisjes vendore është një praktikë e mirë për ndjekjen e realizimit të produkteve të planifikuara në programin buxhetor afatmesëm. Në kuadër të këtij procesi, gjatë vitit 2019, u zhvilluan trajnime në të gjitha bashkitë për

---

treguesit e performancës si një hap i duhur për buxhetimin mbi bazë performance. Gjatë pjesës së dytë të vitit 2019, shumë bashki të tjera mbështetur në produktet buxhetore të planifikuara në PBA, realizuan monitorimin e zbatimit të buxhetit mbi bazën e treguesve të performancës. Në kuadër të procesit të reformimit të monitorimit të zbatimit të buxhetit vendor, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është mbështetur në shtyllat kryesore si më poshtë vijon:

- Monitorimi efikas dhe i mirë-integruar i shpenzimeve publike në nivel vendor me synim rritjen e efektshmërisë dhe përdorimit ekonomik të fondeve publike **përmes unifikimit të formateve të raporteve të monitorimit të buxhetit vendor.**

- Nga ana tjetër, u realizua unifikimi i **klasifikimit të shpenzimeve buxhetore i njësive të vetëqeverisjes vendore** me sistemin e klasifikimit ndërkombëtar COFOG në vitin 2018, një hap i rëndësishëm efektet e të cilit u ndjenë gjatë monitorimit të zbatimit të buxhetit vendor gjatë vitit 2019.
- Gjatë kësaj kohe, **forcimi i disiplinës financiare në nivel vendor**, nëpërmjet vendosjes së parimeve, rregullave, proceseve dhe procedurave për hartimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kanë synuar parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Për më tepër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar një udhëzim i cili ka për qëllim të zbatojë një sistem monitorimi për identifikimin e njësive të cilat përballen me probleme financiare. Konsiderohet thelbësor ndërtimi i një sistemi monitorimi buxhetor i cili ka për qëllim transparencën, bashkëpunimin dhe raportimin të strukturat qendrore.

---

# 1. Hyrje

---

Monitorimi i zbatimit të buxhetit si pjesë përbërëse e procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor është në fokusin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për t'u zbatuar në të gjitha NJVQV-të. Këto procese janë unifikuar përmes miratimit të udhëzimit standard nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore" dhe po zbatohen me asistencën e projektit "Bashki të Forta". Nëpërmjet strategjisë së menaxhimit të financave publike në nivel vendor për periudhën 2019-2022 synohet arritja e produkteve si më poshtë:

- Forcimi i rolit të Planifikimit Strategjik dhe mirëmenaxhimi i buxhetit në nivel vendor;
- Menaxhimi i efektshëm i të ardhurave;
- Krijimi i strukturave për realizimin e kontrollit dhe auditimit të brendshëm të efektshëm;
- Kapacitete të rritura të MFE-së për të menaxhuar reformat e MFP-së në nivelin e qeverisë vendore;
- Zbatimi i IPSIS-it në nivel vendor.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nëpërmjet Drejtorisë së Financave Vendore, i ka orientuar të gjitha prioritetet e planit të punës në drejtim të realizimit të plotë të përcaktimeve të strategjisë së sipërcituar. Këto objektiva strategjike të menaxhimit të financave publike në nivel vendor do të arrihen nëpërmjet:

- Përmirësimit të raporteve të monitorimit, duke u fokusuar te: krijimi i detyrimeve të prapambetura, raportet e shpenzimeve operative, të personelit dhe investimeve në drejtim të efektshmërisë së tyre në rritjen e cilësisë së shërbimeve publike etj;
- Përmirësimit të aftësive monitoruese dhe raportuese për të identifikuar në kohë probleme potenciale gjatë zbatimit të buxhetit nëpërmjet organizimit të trajnimeve periodike të stafit të drejtorive të financës dhe buxhetit;
- Përmirësimit të raportimit dhe monitorimit të performancës financiare për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet rritjes së cilësisë në mënyrën dhe përmbajtjen e raportimit të zbatimit të buxhetit vendor;
- Menaxhimit të efektshëm të të ardhurave, duke rishikuar politikën e taksave me qëllim rritjen e efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave vendore, zvogëlimin të hendekut tatimor dhe luftimit të evazionit fiskal dhe ekonomisë informale;
- Ndjekjes dhe rekomandimeve lidhur me parashikimin shumë optimist të të ardhurave vendore, dukuri e cila në vitet e kaluara është shoqëruar me buxhete të paqëndrueshme duke krijuar rreziqe për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

---

# 2. Metodologjia

---

## Shpjegimi i termave kryesore

---



**Struktura e Programit:** Buxhetimi i bazuar në programe ka evoluar në dekadat e fundi, i mbështetur gjithashtu edhe nga politikat dhe rekomandimet e Bankës Botërore në zbatim të ristrukturimit dhe përmirësimit të proceseve ekzistuese të buxhetit. Metodologjia e miratuar për hartimin e programit buxhetor afatmesëm ka përfshirë si pjesë të saj deklaratën e misionit, si dhe përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave kjo për të shpjeguar pse po shpenzohen paratë publike. Kjo formë buxhetimi është një mënyrë për të alokuar burimet dhe për të arritur objektiva specifike bazuar në qëllimet e programit dhe rezultatet e matura.”<sup>1</sup>

Në këtë qasje i gjithë kuadri i planifikimit dhe i buxhetimit është i orientuar drejt rezultateve.



**Treguesit e performancës** Njësitë e matjes që ndihmojnë për vlerësimin e arritjes së objektivave që ka vendosur një bashki për secilin ose për të gjitha programet e buxhetit për një periudhë kohore prej një viti. Treguesit e performancës në lidhje me programet buxhetore janë zakonisht jo-financiarë.



**Monitorimi i zbatimit të buxhetit:** Monitorimi është një proces i vetëvlerësimit të performancës, i cili arrihet nëpërmjet krahasimit të treguesve të planifikuar me performancën faktike, siç përcaktohet në Udhëzimin e MFE-së nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”.



**Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit:** Është instrumenti kryesor raportues i përdorur nga bashkitë për të raportuar mbi zbatimin e buxhetit bashkiak. Raporti jep një përmbledhje të detajuar të shpenzimeve sipas programit, klasifikimit ekonomik, duke krahasuar shifrat e planifikuara kundrejt atyre faktike duke nxjerrë në këtë mënyrë shkallën e zbatimit.



**Raportet e performancës:** Janë versionet miqësore për përdoruesit të Raporteve të Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit që 33 bashki arritën të përgatitin për vitin 2019. Këto formate kanë prirjen të ndërthurin kërkesat ligjore për të dhëna financiare dhe jo-financiare në një format të shkurtër, konciz dhe të saktë që është i projektuar kryesisht për qëllime informimi dhe komunikimi me organin legjislativ, me qytetarët dhe me strukturat e tjera qeveritare.

---

1) K. Carter, *Rishikimi i buxhetimit të bazuar në performancë: Raport për Reformën e Buxhetit të Shtetit – Financat legjislative, Dokumenti 91, Denver, Konferenca Kombëtare e Legjislativave Shtetërore, fq. 2-3*



Tabela 1: Lista e 36 programeve të paraqitura nga MFE-ja për pushtetin vendor

Emri i programit
P.1 Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi
P.2 Çështje financiare dhe fiskale
P.3 Gjendja civile
P.4 Pagesa e shërbimit të borxhit të brendshëm
P.5 Shërbimet e policisë vendore
P.6 Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi
P.7 Marrëdhëniet me komunitetin
P.8 Ndihma për zhvillimin ekonomik
P.9 Shërbimi, akreditimi, inspektimi i tregut
P.10 Shërbimet bujqësore, inspektimi dhe siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit
P.11 Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit
P.12 Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave
P.13 Sistemi rrugor (rural + urban)
P.14 Transporti publik
P.15 Projektet e zhvillimit
P.16 Zhvillimi i turizmit
P.17 Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave
P.18 Menaxhimi i ujërave të zeza dhe i kanalizimeve
P.19 Programet për mbrojtjen e mjedisit
P.20 Ndërgjegjësimi mjedisor
P.21 Planifikimi urban vendor
P.22 Programet e zhvillimit
P.23 Shërbimet publike vendore
P.24 Furnizimi me ujë të pijshëm
P.25 Ndrçimi rrugor
P.26 Shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor
P.27 Sport dhe reklamë
P.28 Trashëgimia kulturore, ngjarjet artistike dhe kulturore
P.29 Arsimit fillor dhe parashkollor
P.30 Arsimi i përgjithshëm (para-universitar)
P.31 Arsimi profesional
P.32 Kujdesi shoqëror për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara
P.33 Kujdesi social për të moshuarit
P.34 Kujdesi shoqëror për familjet dhe fëmijët
P.35 Papunësia, arsimi dhe trajnimi
P.36 Strehimi social

Tabela 2: Shembuj të qëllimeve dhe të objektivave të një programi

**P.12 Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave**

Qëllimi i programit	Rritja e të ardhurave të taksave vendore
	Përmirësimi i fondit pyjor dhe kullor
	Rritja e produkteve pyjore (gështenja, arra, etj.) dhe bimëve medicinale
Objektivi i programit	Rritja e të ardhurave të banorëve të zonës pyjore
	Rritja e produkteve nga pyjet dhe kullotat;
Treguesit e performancës	Numri i inspektimeve për 1000 hektarë pyje dhe kullota

Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22, datë 30.08.2018, „Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të NJVQV-ve“ është nxjerrë në zbatim të Ligjit 68/2017 „Për financat e vetëqeverisjes vendore“ në lidhje me ciklin e monitorimit dhe raportimit të NJVQV-ve. Sipas tij, bashkitë duhet të hartojnë 3 raporte monitorimi gjatë një viti, ku raporti i fundit të mbulojë tërë vitin.



**Struktura dhe Përmbajtja e Raportit të Monitorimit është një nga pjesët kryesore që trajtohet nga udhëzimi, duke përbërë themelin e metodologjisë së Raportit. Më poshtë shpjegohen kërkesat ligjore në lidhje me këtë pjesë:**

- ✓ *Parathënia: Përshkrim i përgjithshëm i procesit të monitorimit dhe zbatimit të buxhetit;*
  - ✓ *Detaje mbi politikat dhe objektivat e programeve specifike të shoqëruara me mënyrën e arritjes së tyre përmes mbledhjes së të ardhurave dhe alokimit të shpenzimeve;*
  - ✓ *Plotësimi i anekseve të paracaktuara ku të gjitha vlerat janë renditur sipas vlerave të planit dhe vlerave faktike të periudhës nën vëzhgim.*
    - i)** Aneksi 1: Shpenzimet sipas programit.
    - ii)** Aneksi 2: Shpenzimet e programit/aktivitetit ekonomik.
    - iii)** Aneksi 3: Realizimi i produkteve të programit/treguesve të performancës.
    - iv)** Aneksi 4: Arritja e objektivave të programeve.
    - v)** Aneksi 5: Projektet e investimeve me fonde të huaja ose të veta.
  - ✓ *Pjesa përshkuese me shpjegime për secilën prej formateve të mësipërme.*
    - i)** Rezultatet sipas programit dhe masat e marra për përmirësimin e rasteve problematike për shkak të ndryshimeve krahasuar me planin fillestar.
    - ii)** Niveli i zbatimit të treguesve të performancës në krahasim me planin.
    - iii)** Niveli i zbatimit të produkteve në krahasim me planin në sasi dhe vlerë duke zbuluar kështu kostot për njësi.
    - iv)** Niveli i arritjeve të qëllimeve dhe objektivave të programeve që mbulojnë çështjet gjinore.
    - v)** Shpjegimet në rastet e ndryshimeve të shpenzimeve buxhetore krahasuar me planin fillestar në nivel të një programi ose në një aktivitet ekonomik të pasqyruar në nivel produkti dhe në nivel të treguesve të performancës.
    - vi)** Analiza e nivelit të zbatimit të investimeve në nivel vendor.
    - vii)** Afati dhe struktura e detyrimeve tatimore të identifikuara, të cilat nuk mbliidhen në afat.
    - viii)** Treguesit kryesorë financiarë.
- Kërkesa të tjera thelbësore që nënkuptohen:***
- Raporti i Monitorimit përfshin informacion financiar dhe jo-financiar (produkte të tilla si km rrugë dhe tregues të performancës të shprehur në përqindje);
  - Të ardhurat sipas burimeve dhe realizimi i tyre është një temë e rëndësishme që shpesh haset në raportet e llogaridhënies që mbulojnë financat e NJVQV-ve dhe që haset tashmë edhe në raportet e monitorimit të paraqitura nga bashkitë në vitin 2018;
  - Formatet e raportimit dhe përshkrimet e informacionit financiar dhe jo-financiar të përfshira në raportet e monitorimit duhet të plotësojnë kërkesat e udhëzimit,

---

ndërkohë që duhet të jenë edhe miqësore për përdoruesit, me një gjuhë lehtësisht të lexueshme dhe gjithëpërfshirëse, në mënyrë që t'i komunikojnë gjetjet tek aktorët e ndryshëm;

- E fundit, por jo më pak e rëndësishme, cilësia dhe besueshmëria e të dhënave të siguruar financiare apo teknike ka një rëndësi të madhe përtej përputhshmërisë me kërkesën ligjore për të përmbushur misionin e monitorimit dhe raportimit të zbatimit të buxhetit të NJVQV-ve.

Raportet e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit, të miratuara nga këshilli bashkiak, dorëzohen në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për rishikim, sipas Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018. Këto dokumente kontrollohen nga Drejtoria e Financave Vendore në MFE dhe vërejtjet dhe rekomandimet i dërgohen secilës njësi të vetëqeverisjes vendore. Rishikimi dhe analiza e RMZB-së së paraqitur është bërë në mënyrë më të gjerë për qëllimin e Raportit Kombëtar. Puna përgatitore vijoi në tre faza:

### 1. Puna në zyrë:

Gjatë së cilës u rishikuan, u analizuan dhe u krahasuan me kujdes raportet vjetore të paraqitura të monitorimit në raport me listën e kërkesave ligjore të renditura në Tabelën

3, e cila tregon të gjitha kriteret e marra në shqyrtim për qëllimin e këtij raporti dhe përmasës së kampionit - numri i bashkive për të cilat është kryer vëzhgimi.

### 2. Vizitat në terren:

Vizitat në terren janë realizuar pothuajse në të gjitha bashkitë për të kuptuar sfidat dhe përparimin e bashkive, veçanërisht në lidhje me përdorimin e elementeve të performancës, cilësinë e të dhënave teknike dhe financiare të raportuara, proceset e brendshme dhe aktorët kryesorë të përfshirë në përgatitjen e raportit monitorimit.

### 3. Krijimi i bazës së të dhënave dhe analiza e të dhënave:

**Përmasa e kampionit:** Vlerësimi i RMZB-së është bërë në 61 bashki; kështu, kampioni përfshin të gjitha bashkitë për shumicën e zërave subjekt të vëzhgimit.

Siç tregon tabela, kriteret klasifikohen në:

- Kriteret e kërkesave të përputhshmërisë;
- Përdorimi nga këshilli bashkiak dhe komuniteti.

**Tabela 3:** Kriteret e vlerësimit dhe përmasa e kampionit

	Kriteret e vlerësimit	Përmasa e kampionit bashkiak	
Kërkesat e përputhshmërisë	Përgatitja e një raporti	61	
	Struktura e programit përputhet me kërkesat e udhëzimit të PBA-së	Metoda cilësore	
	Qëllimet, objektivat janë specifikuar; kodet e programit përkojnë me emërtesat e programit	Metoda cilësore	
	Ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar	Metoda cilësore	
	Paraqitja e të ardhurave sipas burimeve	61	
	Realizimi faktik i të ardhurave	61	
	Shpenzimet sipas programit dhe realizimit	61	
	Raportimi i shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik	61	
	Raportimi i treguesve financiar	61	
	Lista e investimeve	61	
	Elementet e performancës	61	
	Përputhshmëria e programeve të raportuara në PBA dhe RMZB	61	
	Përdorimi i raportit nga këshilli bashkiak dhe komuniteti	Raporti është diskutuar në këshill bashkiak	61
		Raporti është hedhur në Faqen Zyrtare në Internet	61
Renditja e Bashkive	Pikëzimi për bashki në bazë të kriterëve të plotësuar (kampioni 61 bashki)	61	

Kur vëzhgimi nuk është kryer në 61 bashki, dhe përmasa e kampionit është rrjedhimisht më e vogël se 61, atëherë përdoret metoda e vlerësimit cilësor, pas hapave të treguara në Tabelën 4.

**Tabela 4:** Metoda e përdorur për elementet e vlerësuara në mënyrë cilësore

Hapi 1	Hapi 2	Hapi 3	Shënim	Kampioni
Zgjedhja e Kampionit bashkiak 12 (1 për qark)	Kontrollimi i Anekseve ose Raportit për të parë nëse kriteri është plotësuar	Përshkrimi i gjetjeve	Zbatohet për Kriterin 2, 3, 4	Rrogozhinë, Durrës Patos, Shkodër, Dibër, Has, Himarë, Urë Vajgurore, Dropull, Librazhd, Lezhë, Korçë

Të dhënat janë emërtuar si vijon: elementi që është i pranishëm korrespondon me "Po", elementi që nuk është i pranishëm korrespondon me "Jo", elementi pjesërisht i pranishëm korrespondon me "Pjesërisht", dhe nuk është paraqitur asnjë informacion i disponueshëm pavarësisht nëse elementi është i pranishëm apo jo korrespondon me "Nuk aplikohet".

Rezultatet analizohen në tekst sipas hartave. Raporti ofron edhe një analizë më të thelluar të përdorimit të elementeve të performancës në kreun përkatës.

## Ecuria e bashkive në krahasim me një vit më parë

Për çdo kriter është krahasuar statusi i plotësimit me një vit më parë. Kriteri është cilësuar me «Përmirësim», «Njësoj», «Përkeqësim» ku:

Tabela 5: Ndryshimi në krahasim me 2018

Statusi	Shpjegimi i Statusit
Përmirësim	<ul style="list-style-type: none"><li>Nëse kriteri nuk është plotësuar në vitin 2018 por është plotësuar në vitin 2019;</li><li>Nëse në vitin 2018 është plotësuar pjesërisht ndërsa në vitin 2019 është realizuar i plotë;</li></ul>
Njësoj +	<ul style="list-style-type: none"><li>Nëse kriteri është plotësuar si në vitin 2018 ashtu edhe në vitin 2019;</li></ul>
Njësoj -	<ul style="list-style-type: none"><li>Nëse kriteri nuk është plotësuar si në vitin 2018 ashtu edhe në vitin 2019;</li></ul>
Përkeqësim	<ul style="list-style-type: none"><li>Nëse kriteri është plotësuar në vitin 2018 dhe nuk është plotësuar në vitin 2019;</li><li>Nëse kriteri është plotësuar në vitin 2018 dhe është plotësuar pjesërisht në vitin 2019;</li><li>Nëse kriteri është plotësuar pjesërisht në vitin 2018 dhe nuk është plotësuar në vitin 2019.</li></ul>

## Renditja e Bashkive

Më pas është zbatuar një pikëzim i përputhshmërisë për të gjitha bashkitë bazuar në kriteret e vlerësuar në mënyrë sasiore sipas të cilave ato janë renditur sipas Tabelës 5.

Tabela 6: Pikëzimi i përputhshmërisë

Pikët	Standardi
11 deri në 8.5 pikë	Përputhshmëri e lartë
8.4 deri në 6 pikë	Mbi mesataren
5.9 deri në 3.5 pikë	Mesatare
3.4 deri në 1 pikë	Nën mesataren
0 pikë	Nuk ka përputhshmëri

**Kufizimet:** Raporti është ndërtuar mbi bazën e kritereve të përputhshmërisë, të cilat përcaktohen në mënyrë sasiore dhe janë pikëzuar. Gjithashtu, në raport paraqitet edhe një grup tjetër kriteresh që vlerësohen vetëm në mënyrë cilësore dhe që nuk pikëzohen.

**Vijueshmëria:** Raporti Kombëtar ka qëllim të sigurojë vijueshmërinë periodike në vite, si një parakusht për krijimin e një produkti më analitik në vitin e ardhshëm.

---

# 3. Përputhshmëria me kriteret e raportimit

---

## 3.1 Rezultatet sipas bashkisë

---

### 1. A kanë prodhuar bashkitë RMZB?

Për vitin 2019, raportin vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit nga 61 bashki e kanë prodhuar 47, ose rreth 79 për qind e tyre, si bashkitë Berat, Kuçovë, Poliçan, Skrapar, Ura Vajgurore, Bulqizë, Dibër, Klos, Mat, Durrës, Krujë, Shijak, Belsh, Cërrik, Elbasan, Librazhd, Përrenjas, Divjakë, Fier, Lushnje, Mallakastër, Patos, Roskovec, Dropull, Gjirokastër, Këlcyrë, Libohovë, Përmet, Devoll, Kolonjë, Korçë, Maliq, Has, Kukës, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Fushë Arrëz, Malësi e Madhe, Shkodër, Vau i Dejës, Kamëz, Tiranë, Delvinë, Sarandë, Selenicë dhe Vlorë.




Këtë raport e kanë prodhuar pjesërisht 6 bashki nga 61 ose rreth 9.8 për qind e tyre, si: Memaliaj, Tepelenë, Pogradec, Pukë, Finiq, si dhe bashkia Himarë.

Bashkitë të cilat nuk e kanë prodhuar raportin vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit të viti 2019 janë 8 bashki nga 61, ose rreth 13 për qind e tyre, si bashkitë: Gramsh, Peqin, Pustec, Tropojë, Kavajë, Rrogozhinë, Vorë, dhe Konispol.

### Krahasimi i këtij raporti me një vit më parë

Viti 2019, si viti i dytë i prodhimit të raportit kombëtar për monitorimin e zbatimit të buxhetit të NJVQV-ve, mundëson krahasimin me raportin e prodhuar një vit më parë jo vetëm në drejtim të plotësimit të kërkesave ligjore por edhe të cilësisë së këtij raporti. Po të krahasojmë raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2019, me atë të prodhuar për zbatimin e buxhetit të vitit 2018, evidentohet se kemi përmirësim të raportimit në 6 bashki ose ndryshe rreth 10 për qind të bashkive gjithsej, si bashkia Poliçan, Skrapar, Përrenjas, Libohovë, Devoll dhe Finiq.

Harta 1: Bashkitë që kanë dorëzuar një Raport Monitorimi në vitin 2019



Këto përmirësime konsistojnë në:

- Bashki të cilat në vitin 2018 e kanë prodhuar pjesërisht raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit, ndërsa në vitin 2019 e kanë prodhuar atë të plotë si bashkitë Poliçan, Skrapar dhe Devoll;
- Bashki të cilat në vitin 2018 nuk e kanë prodhuar fare këtë raport, ndërsa për vitin 2019 e kanë prodhuar si bashkitë Përrenjas dhe Libohovë;
- Bashki të cilat në vitin 2018 nuk e kanë prodhuar raportin e monitorimit ndërsa në vitin 2019 e kanë prodhuar atë pjesërisht si bashkia Finiq.

Po të krahasojmë raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2019 me atë të prodhuar për zbatimin e buxhetit të viti 2018, bashkitë të cilat paraqiten me regres janë 10 bashki ose ndryshe rreth 16 për qind e tyre, të tilla si Gramsh, Peqin, Memaliaj, Tepelenë, Tropojë, Pukë, Rogozhinë, Vorë, Himarë dhe Pogradec.

Ky regres konsiston në:

- Bashkitë të cilat në vitin 2018 e kanë prodhuar raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit, ndërsa në vitin 2019 nuk e kanë prodhuar atë, të tilla si Gramsh, Tropojë, Rogozhinë dhe Vorë;
- Bashkitë të cilat në vitin 2018 e kanë prodhuar raportin ndërsa në vitin 2019 e kanë prodhuar atë pjesërisht të tilla si Memaliaj, Tepelenë, Pogradec, Pukë dhe Himarë;
- Bashkitë të cilat në vitin 2018 e kanë prodhuar raportin pjesërisht, ndërsa në vitin 2019 nuk e kanë prodhuar atë si është Bashkia Peqin.

Me të njëjtin status nga njëri vit në tjetrin paraqiten 45 bashki nga 61 në total ose rreth 75 për qind e tyre. Nga këto, 42 bashki e kanë prodhuar këtë tregues si në vitin 2018 dhe në vitin 2019 të tilla si: Berat, Kuçovë, Ura Vajgurore, Bulqizë, Dibër, Klos, Mat, Durrës, Krujë, Shijak, Belsh, Cërrik, Elbasan, Librazhd, Divjakë, Fier, Lushnje, Mallakastër, Patos, Roskovec, Dropull, Gjirokastër, Këlcyrë, Përmet, Kolonjë, Korçë, Maliq, Has, Kukës, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Fushë Arrëz, Malësi e Madhe, Shkodër, Vau i Dejës, Kamëz, Tiranë,

Delvinë, Sarandë, Selenicë dhe Vlorë, ndërsa 3 bashki nuk e kanë prodhuar atë si në vitin 2018 ashtu edhe në vitin 2019 të tilla si: Pustec, Kavajë, dhe Konispol.

## 2. Raportimi i shpenzimeve sipas programeve dhe kërkesave të Aneksit 1

Një ndër përcaktimet e udhëzimit standard për monitorimin e zbatimit të buxhetit është edhe raportimi i shpenzimeve sipas programeve buxhetore e specifikisht plotësimi i tyre në mënyrë të detajuar sipas formatit të Aneksit 1. Bashkitë të cilat e kanë prodhuar këtë informacion për vitin 2019 janë 53 ose rreth 87 për qind e tyre, nga këto, bashkitë Berat, Kuçovë, Poliçan, Skrapar, Ura Vajgurore, Bulqizë, Dibër, Klos, Mat, Durrës, Krujë, Shijak, Belsh, Cërrik, Elbasan, Librazhd, Divjakë, Fier, Lushnje, Mallakastër, Patos, Roskovec, Dropull, Gjirokastër, Këlcyrë, Libohovë, Memaliaj, Përmet, Tepelenë, Devoll, Kolonjë, Korçë, Maliq, Pogradec, Kukës, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Fushë Arrëz, Malësi e Madhe, Pukë, Shkodër, Vau i Dejës, Kamëz, Tiranë, Delvinë, Finiq, Himarë, Sarandë, Vlorë e kanë prodhuar këtë informacion sipas formatit të aneksit, ndërsa bashkitë Selenicë, Përrenjas dhe Has e kanë prodhuar këtë informacion por jo sipas formatit të Aneksit 1.




Bashkitë të cilat nuk e kanë zbatuar këtë kërkesë janë po ato bashki të cilat nuk e kanë prodhuar raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2019, pra 8 bashki si bashkitë: Vorë, Tropojë, Rogozhinë, Pustec, Peqin, Konispol, Kavajë dhe Gramsh.

### Sa kanë raportuar? A ka ndryshim treguesi në krahasim me vitin 2018?

Po të krahasojmë raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2019 me një vit më parë, për këtë tregues vlen të theksohet fakti se kemi përmirësim të raportimit të këtij treguesi në 12 bashki.



Harta 2: Klasifikimi i shpenzimeve sipas programeve në vitit 2019



Këto përmirësime konsistojnë në:

- Bashkitë të cilat e kanë prodhuar atë pjesërisht në vitin 2018, ndërsa në vitin 2019 e kanë prodhuar atë të plotë tilla si bashkia Memaliaj dhe Kamëz;
- Bashkitë të cilat nuk e kanë prodhuar këtë informacion në vitin 2018, ndërsa në vitin 2019 e kanë prodhuar atë të tilla si Dibër, Përrenjas, Libohovë, Korçë, Maliq, Pogradec, Has, Kukës, Mirditë dhe Finiq.

Ky tregues shfaqet me regres nga njëri vit në tjetrin në 2 bashki si Gramshi dhe Peqini të cilat e kanë prodhuar raportin në vitin 2018 ndërsa në vitin 2019 nuk e kanë prodhuar atë.

Me të njëjtin status nga njëri vit në tjetrin paraqiten 47 bashki nga 61 ose ndryshe rreth 77 për qind e tyre. Nga këto, 41 bashki e kanë raportuar këtë tregues si në vitin 2018 dhe në vitin 2019 si bashkitë: Berat, Kuçovë, Poliçan, Skrapar, Ura Vajgurore, Bulqizë, Klos, Mat, Durrës, Krujë, Shijak, Belsh, Cërrik, Elbasan, Librazhd, Divjakë, Fier, Lushnje, Mallakastër, Patos, Roskovec, Dropull, Gjirokastrë, Këlcyrë, Përmet, Tepelenë, Devoll, Kolonjë, Kurbin, Lezhë, Fushë Arrëz, Malësi e Madhe, Pukë, Shkodër, Vau i Dejës, Tiranë, Delvinë, Himarë, Sarandë, Selenicë dhe Vlorë, ndërsa 6 bashki nuk e kanë raportuar atë si në vitin 2018 ashtu edhe në vitin 2019, si bashkitë: Pustec, Tropojë, Kavajë, Rrogozhinë, Vorë, dhe Konispol.

### **3. Programet buxhetore në programin buxhetor afatmesëm janë të njëjta me ato të raportimit për vitin 2019**

Në vitin 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë nisma për unifikimin e programeve buxhetore për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke miratuar një listë e cila shteron funksionet ligjore të përcaktuara për pushtetin vendor. Gjatë analizës së zhvilluar mbi përdorimin e programeve buxhetore nuk është marrë parasysh vetëm

fakti nëse bashkitë kanë përdorur të njëjtën strukturë programi si në PBA dhe Monitorim por është vlerësuar edhe nëse në Monitorim janë përdorur programet sipas përcaktimeve të Shtojcës nr. 1 të udhëzimit nr.23, datë 30.07.2018 "Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore".

Bashkitë të cilat programet buxhetore i kanë të njëjta si në Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 ashtu edhe në Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit të viti 2019 janë 21 ose ndryshe rreth 34 për qind e bashkive gjithsej.

Bashkitë të cilat programet buxhetore i kanë pjesërisht të njëjta midis Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 dhe Raportit të Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit të viti 2019 janë 28, ose rreth 46 për qind e tyre.

Bashkitë të cilat programet buxhetore të përdorura në Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, nuk i kanë të njëjta me ato të përdorura në Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit të viti 2019 janë 12 bashki nga të cilat 8 janë ato bashki të cilat nuk e kanë prodhuar fare Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit të vitit 2019 si dhe 2 të cilat nuk kanë raportuar këtë tregues.




#### **Si ka ndryshuar situata e plotësimit të këtij treguesi gjatë viti 2019 në raport me një vit më parë?**

Po të krahasojmë raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit në vitin 2019 me një vit më parë, për këtë tregues vlen të theksohet fakti se kemi përmirësim të raportimit nga njëri vit në tjetrin në 46 bashki.

Këto përmirësime konsistojnë në:

- Bashki të cilat nuk e kanë prodhuar këtë informacion në vitin 2018, ndërsa në vitin 2019 e kanë prodhuar atë janë 19 të tilla si Kuçovë, Bulqizë, Durrës, Belsh, Elbasan, Fier, Mallakastër, Gjirokastrë, Libohovë, Memaliaj, Devoll, Kolonjë, Korçë, Pogradec, Lezhë, Fushë Arrëz, Pukë, Vau i Dejës dhe Himarë;

Harta 3: Të njëjtat programe të raportuara në RMZB-në e vitit 2019 dhe PBA-në 2019-2021



- Bashki të cilat nuk e kanë prodhuar këtë informacion në vitin 2018, ndërsa në vitin 2019 e kanë prodhuar atë pjesërisht që janë 27.

Me të njejtin status nga njëri vit në tjetrin paraqiten 14 bashki nga 61 ose ndryshe rreth 22 për qind e tyre nga të cilat 12 nuk e kanë raportuar këtë tregues as në vitin 2018 dhe as në vitin 2019 të tilla si Dibër, Krujë, Gramsh, Librazhd, Peqin, Pustec, Kukës, Tropojë, Kavajë, Rrogozhinë, Vorë dhe Konispol, si dhe 2 bashki ajo e Shijakut dhe Shkodrës e kanë raportuar këtë tregues si në vitin 2018 dhe në vitin 2019.

Ky tregues shfaqet me regres nga njëri vit në tjetrin në bashkinë Poliçan e cila e ka raportuar të plotë këtë tregues në vitin 2018, ndërsa në vitin 2019 e ka raportuar atë pjesërisht.

#### 4. Shpenzimet e raportuara sipas klasifikimit ekonomik

Për raportimin e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik për vitin 2019, evidentohet se këtë informacion e kanë prodhuar 53 bashki ose ndryshe rreth 87 për qind e tyre. Nga këto, 47 bashki e kanë prodhuar atë në përputhje me Aneksin 2 të udhëzimit standard për monitorimin si bashkitë: Vlorë, Vau i Dejës, Ura Vajgurore, Tiranë, Tepelenë, Skrapar, Shkodër, Shijak, Sarandë, Roskovec, Pukë, Poliçan, Përmet, Patos, Mirditë, Memaliaj, Mat, Mallakastër, Maliq, Malësi e Madhe, Lushnje, Librazhd, Libohovë, Lezhë, Kurbin, Kukës, Kuçovë, Krujë, Korçë, Kolonjë, Këlcyrë, Kamëz, Himarë, Gjirokastër, Fushë Arrëz, Finiq, Fier, Elbasan, Durrës, Dropull, Divjakë, Dibër, Devoll, Delvinë, Cërrik, Bulqizë, Berat, si dhe 6 bashki si: Selenicë, Përrenjas, Pogradec, Klos, Has dhe Belsh e kanë prodhuar këtë informacion por jo sipas formatit të Aneksit 2.

Bashkitë të cilat nuk e kanë përmbushur këtë kërkesë janë po ato bashki të cilat nuk e kanë prodhuar raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2019, pra 8 bashki si: Vorë, Tropojë, Rrogozhinë, Pustec, Peqin, Konispol, Kavajë dhe Gramsh.

#### Sa kanë raportuar? A ka ndryshim treguesi ne krahasim me 2018?

Po të krahasojmë raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit në vitin 2019 më një vit më parë, për këtë tregues vlen të theksohet fakti se kemi përmirësim të raportimit në 23 bashki.




Këto përmirësime konsistojnë në:

- Bashki të cilat në vitin 2018 nuk e kanë prodhuar raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit, ndërsa në vitin 2019 e kanë prodhuar atë si bashkitë: Berat, Kuçovë, Dibër, Korçë, Maliq, Has, Kukës, Mirditë, Kamëz, Himarë, Selenicë, Vlorë, Përrenjas, Këlcyrë, Libohovë dhe Finiq.
- Bashki të cilat në vitin 2018 e kanë prodhuar pjesërisht raportin ndërsa në vitin 2019 e kanë prodhuar të plotë atë si bashkia Mallakastër, Memaliaj, Përmet, Fushë Arrëz, Malësi e Madhe, Pukë dhe Tiranë.

Me të njejtin status nga njëri vit në tjetrin paraqiten 36 bashki nga 61 ose ndryshe rreth 59 për qind e tyre. Nga këto, 30 bashki e kanë raportuar këtë tregues si në vitin 2018 dhe në vitin 2019 të tilla si Poliçan, Skrapar, Ura Vajgurore, Bulqizë, Klos, Mat, Durrës, Krujë, Shijak, Belsh, Cërrik, Elbasan, Librazhd, Divjakë, Fier, Lushnje, Patos, Roskovec, Dropull, Gjirokastër, Tepelenë, Devoll, Kolonjë, Pogradec, Kurbin, Lezhë, Shkodër, Vau i Dejës, Delvinë dhe Sarandë, ndërsa 6 bashki nuk e kanë raportuar atë si në vitin 2018 ashtu edhe në vitin 2019, të tilla si Pustec, Tropojë, Kavajë, Rrogozhinë, Vorë, dhe Konispol.

Regres kemi vetëm në 2 bashki Gramsh dhe Peqin të cilat në vitin 2018 e kanë prodhuar këtë informacion ndërsa në vitin 2019 nuk e kanë prodhuar atë.

Harta 4: Klasifikimi i shpenzimeve sipas aktivitetit ekonomik në vitin 2019



---

## 5. Raportimi i investimeve nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

Për vitin 2019, në raportin vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit kanë përfshirë tabelën e listës së investimeve të realizuara 45 bashki, ose ndryshe rreth 73 për qind e tyre, si bashkia Berat, Kuçovë, Skrapar, Ura Vajgurore, Bulqizë, Dibër, Klos, Mat, Shijak, Durrës, Krujë, Shijak, Belsh, Cërrik, Elbasan, Librazhd, Divjakë, Fier, Lushnje, Mallakastër, Patos, Roskovec, Dropull, Gjirokastrë, Këlcyrë, Libohovë, Memaliaj, Përmet, Tepelenë, Devoll, Kolonjë, Korçë, Maliq, Pogradec, Kukës, Lezhë, Fushë-Arrëz, Malësi e Madhe, Shkodër, Kamëz, Tiranë, Delvinë, Finiq, Himarë, Sarandë dhe Vlorë.

Këtë raport e kanë prodhuar pjesërisht vetëm 3 bashki nga 61 gjithsej ose ndryshe rreth 5 për qind e tyre, të tilla si Përrenjas, Pukë dhe Selenicë. Këto njësi janë konsideruar pjesërisht për shkak se kanë respektuar një pjesë të kërkesave të udhëzimit por jo në përputhje të plotë, si për shembull Bashkia Përrenjas i ka raportuar investimet sipas programeve por jo sipas përcaktimeve të aneksit 5 të udhëzimit apo Bashkia Selenicë e cila ka identifikuar disa projekte të investimeve por pa specifikimet e vlerës së kontratës, nivelin e realizimit etj.

Bashkitë të cilat nuk e kanë prodhuar raportin e realizimit të projekteve të investimeve të vitit 2019 janë 13 bashki nga 61, ose ndryshe rreth 21 për qind e tyre, të tilla si bashkia Poliçan, Gramsh, Peqin, Pustec, Has, Tropojë, Kurbin, Mirditë, Kavajë, Rrogozhinë, Vorë, Vau i Dejës dhe Konispol.

### Si ka ndryshuar situata e plotësimit të këtij treguesi gjatë viti 2019 në raport me një vit më parë?

Analiza krahasimore në raport me një vit më parë është një pjesë e rëndësishme e këtij raporti, dhe si rrjedhim në këtë seksion do të marrim në analizë nëse për këtë tregues të raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit 2019, është ruajtur i njëjti standard,




përmirësuar, apo përkeqësuar me raportimin e vitit 2018. Duke marrë në analizë njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit 2018 nuk kanë paraqitur formatin e investimeve por që kanë përmirësuar situatën duke e paraqitur atë në vitin 2019 janë 22 bashki ose 36% e bashkive gjithsej, të tilla si bashkia Berat, Ura Vajgurore, Bulqizë, Dibër, Klos, Mat, Shijak, Belsh, Cërrik, Elbasan, Librazhd, Përrenjas, Libohovë, Tepelenë, Korçë, Maliq, Kukës, Lezhë, Kamëz, Tiranë, Finiq dhe Vlorë. Në tërësi vlen shumë të vlerësohet fakti që një pjesë e konsiderueshme e bashkive kanë ardhur në përmirësim në plotësimin e këtij formati në raport me një vit më parë, tregues ky i rëndësishëm për ecurinë e njëjësive të vetëqeverisjes vendore.

Gjithashtu, ekzistojnë njësi të vetëqeverisjes vendore që për arsye të ndryshme në krahasim me raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2018, në vitin 2019 nuk e kanë paraqitur formatin e listës së projekteve të investimeve. Njësitë e vetëqeverisjes vendore që nuk e kanë paraqitur këtë format ndryshe nga një vit më parë janë Bashkia Peqin dhe Vau i Dejës. Nga ana tjetër, në regres për plotësimin e këtij formati në raport me një vit më parë janë bashkia Pukë dhe Selenicë, ku nga një plotësim i saktë në vitin 2018 e kanë plotësuar pjesërisht këtë format në vitin 2019.

Nga ana tjetër, ekzistojnë 38 bashki ose 63.9% e totalit të njëjësive të cilat kanë ruajtur të njëjtin standard në vitin 2019 në raport me një vit më parë lidhur me plotësimin ose jo të formatit të investimeve publike të realizuara gjatë vitit buxhetor, në raportin vjetor të zbatimit të buxhetit. Bashkitë të cilat kanë ruajtur të njëjtin standard duke e plotësuar këtë format si në vitin 2018 ashtu edhe në vitin 2019 janë bashkitë Kuçovë, Skrapar, Durrës, Krujë, Divjakë, Fier, Lushnje, Mallakastër, Patos, Roskovec, Dropull, Gjirokastrë, Këlcyrë, Memaliaj, Përmet, Devoll, Kolonjë, Pogradec, Fushë Arrëz, Malësi e Madhe, Shkodër, Delvinë, Himarë dhe Sarandë. Ndërkohë që bashkitë të cilat vazhdojnë të ruajnë të njëjtin trend negativ duke mos e plotësuar këtë format si në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit 2018 ashtu edhe në 2019 janë njësitë si Poliçan, Gramsh, Pustec, Has, Tropojë, Kurbin, Mirditë, Kavajë, Rrogozhinë, Vorë dhe Konispol.



Harta 5: Raportimi për investimet kryesore të vitit 2019



## 6. Përdorimi i treguesve të performancës në RMZB-2019

Gjatë vitit 2019, 31 bashki kanë përdorur elemente performance; tregues dhe produkte në RMZB duke plotësuar aneksin 3 dhe 4 në përputhje me udhëzimin standard të monitorimit. 25 bashki ose 41 përqind i kanë dorëzuar të plotë këto anekse kurse 6 prej tyre i kanë dorëzuar me një plotësim të pjesshëm. Me plotësim të pjesshëm kuptojmë dorëzimin e vetëm njërit prej anekseve ose mos plotësimin e plotë të formatit udhëzues të vënë në dispozicion nga MFE-ja për këto anekse. Gjithsej mbi gjysma e bashkive të Shqipërisë ka dorëzuar informacion mbi elementet e performancës në raportin e zbatimit të buxhetit. Bashkitë të cilat e kanë plotësuar këtë kriter janë: Berat, Skrapar, Bulqizë, Dibër, Cërrik, Elbasan, Fier, Mallakastër, Patos, Dropull, Gjirokastrë, Libohovë, Memaliaj, Përmet, Tepelenë, Kolonjë, Korçë, Maliq, Kukës, Lezhë, Pukë, Tiranë, Finiq, Himarë, Urë Vajgurore, Belsh, Këlcyrë, Vau i Dejës, Delvinë dhe Vlorë.

Këtë informacion, e kanë raportuar pjesërisht bashkitë: Ura Vajgurore, Belsh, Këlcyrë, Vau i Dejës, Delvinë dhe Vlorë.

### Si ka ndryshuar situata e plotësimit të këtij kriteri gjatë vitit 2019 në raport me një vit më parë?

Ky kriter ka përmirësim të dukshëm në krahasim me një vit më parë. Nëse vjet vetëm 6 bashki e kishin përbushur kriterin në mënyrë të plotë apo të pjesshme, duke ofruar informacionin në lidhje me qëllimet, objektivat sipas programit dhe elementet e performancës, raportimi i plotë sipas kërkesave është realizuar nga 25 bashki kurse nga 6 bashki të tjera raportimi është realizuar në mënyrë të pjesshme. 29 bashki gjithsej, pra pothuajse gjysma kanë shënuar përmirësim në raportimin e këtij kriteri<sup>2</sup> kurse 2 bashki kanë ruajtur të njëjtin status

<sup>2</sup> Përmirësim konsiderohet nëse bashkitë kalojnë nga statusi i mos dorëzimit në plotësim të aneksit, nga plotësimi i pjesshëm në plotësim të plotë

pozitiv si vjet, bashkia Shkodër dhe Gjirokastrë. Vetëm një bashki nuk e ka përbushur këtë kriter duke shënuar përkeqësim në krahasim me një vit më parë. 31 bashki kanë ruajtur të njëjtin status si një vit më parë që në këtë rast përkthehet në mos plotësim të kriterit, pra plotësimin të aneksit 3 dhe 4. Bashkitë që kanë shënuar përmirësim në krahasim me vjet janë: Berat, Skrapar, Bulqizë, Dibër, Cërrik, Elbasan, Fier, Mallakastër, Patos, Dropull, Libohovë, Memaliaj, Përmet, Tepelenë, Kolonjë, Korçë, Maliq, Kukës, Lezhë, Pukë, Tiranë, Finiq, Himarë, Urë Vajgurore, Belsh, Këlcyrë, Vau i Dejës, Delvinë dhe Vlorë.

### 6.1 Analiza e elementeve të performancës




Në këtë sesion do të analizojmë përdorimin e elementeve të performancës në RMZB-të e vitit 2019.

Së pari treguesit u vëzhguan nga pikëpamja e përkatësisë në programe buxhetore. Nga 36 programet buxhetore të përdorura nga NJVQV-të, 11 programet e paraqitura në figurën 1 rezultojnë me frekuencë më të lartë të përdorimit të treguesve të performancës, pra 31 bashkitë të cilat kanë plotësuar aneksin 3 dhe 4 kanë përdorur me shpesh tregues në këto 11 programe. Sikurse vihet re, këto programe i përkasin sektorit të arsimit, ose shërbimeve konkrete të ofruara nga NJVQV-të si: Administrimi i pyjeve dhe kullotave, Menaxhimi i Infrastrukturës dhe Kullimit, Menaxhimi i Mbetjeve, Rrjeti Rrugor etj. Bashkitë e kanë gjykuar të arsyeshme përdorimin e treguesve për të shpjeguar arritjet e tyre gjatë zbatimit të buxhetit në këto programe. Në grafik është cilësuar edhe se cilët kanë qenë treguesit të cilët janë përdorur më shpesh. Në krahasim me një vit më parë mund të thuhet se natyra e programeve të cilat raportohen me tregues performance është e njëjtë me vitin e kaluar.

Ajo që vihet re në krahasim me vitin e kaluar është rritja e frekuencës së përdorimit të treguesve nga bashkitë si dhe rritja e numrit të treguesve të përdorur për program. Treguesit shprehin një raport midis dy të dhënash si: Kilometra kanal kullues të pastruar kundrejt totalit të rrjetit kullues të bashkisë në % ose ndryshimin e një të dhëne në kohë si p.sh.: Ndryshimi në krahasim me një vit më parë i



Harta 6: Përdorimi i treguesve të performancës në dokumentet e RMZB-së në vitin 2019.



gjatësisë së rrjetit rrugor në km linear. Vihet re një përmirësim në formulimin e tyre.

Grafiku 1 shtjellon përdorimin e treguesve të performancës, nga ku duket se sa bashki e kanë përdorur një tregues, ndërkohë që frekuenca më e lartë në përdorimin e një treguesi është në 23 bashki.


Këtë vit bashkitë i kanë përdorur më shpesh elementet e performancës për të shprehur arritjen e objektivave krahas ekzekutimit të fondeve buxhetore. Gjithashtu vihet re një tendencë unifikimi në raportimin e treguesve të ngjashëm sikurse tregon figura 1 dhe grafiku 1. Vihet re gjithashtu një prirje për të raportuar nëpërmjet treguesve ato aspekte të ofrimit

të shërbimit të cilat përbëjnë kërkesë ligjore apo janë të cilësuar në strategjitë kombëtare sektoriale si p.sh.: Mbulimi i popullatës me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, kundrejt totalit të popullsisë, shprehur në %, e shprehur në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035 (miratuar me VKM nr. 418, datë 27.05.2020 - për referencë fq. 34); numri mesatar i nxënësve në një klasë, Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020 (ref. fq. 14) , Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit gjithsej të punonjësve të bashkisë, Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015-2020 (ref. fq 17) .

Figura 1: Programet me frekuecë më të lartë të treguesve të performancës

Programi	Arsimi bazë dhe parashkollor	Administrimi i pyjeve	Menaxhimi infrastrukturës së vaditjes dhe kullimit	Arsimi i përgjithshëm (mesëm)
Treguesi	Numri mesatar i fëmijëve për një punonjës mësues në arsimin parashkollor	Numri i punonjësve për 1000 ha pyje dhe kullota	Km kanal vaditës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujëtare në pronësi të bashkisë (në %)	Numri mesatar i nxënësve në klasë
Treguesi	Numri mesatar i fëmijëve në një klasë të parashkollorit	Numri i kontrolleve dhe inspektimeve për 1000 ha pyje dhe kullota	Km kanal kullues të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve kulluese në pronësi të bashkisë (në %)	
Treguesi	Numri mesatar i nxënësve të arsimit bazë në një klasë			
Programi	Menaxhim Administrim Planifikim	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	Kujdesi Social për Familje dhe Fëmijët	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore
Treguesi	Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	Dalje nga stacioni (ndryshimi në sekonda)	Numri personave të mbështetur me pagesë invaliditeti (ndryshimi vjetor në numër)	Rrjeti rrugor (ndryshimi vjetor në km linear) i ndarë sipas rrugë urbane dhe rrugë rurale
Treguesi	Ditë trajnimi për persona në vit (mesatarisht)	Numri i rasteve të menaxhuara për shuarjen e zjarrit (ndryshimi vjetor në %)		
Programi	Rrjeti rrugor (rural + urban)	Menaxhimi i mbetjeve	Shërbime publike vendore	
Treguesi	Rrjeti rrugor (ndryshimi vjetor në km linear) i ndarë sipas rrugë urbane dhe rrugë rurale	Mbulimi i popullatës me shërbim (në % kundrejt totalit të popullsisë së bashkisë)	Mbulimi me hapësira të gjelbërta (Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt popullsisë totale të bashkisë)	

Grafiku 1: Treguesit më të përdorur në RZMB 2019



## 7. Raportimi i treguesve financiarë

Në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2019 konstatohen se kanë përdorur treguesit financiarë 21 bashki, ose rreth 34.4% e njësive. Bashkitë të cilat e kanë plotësuar këtë format janë Berat, Kuçovë, Skrapar, Bulqizë,

Dibër, Durrës, Belsh, Cërrik, Divjakë, Fier, Lushnje, Patos, Kolonjë, Korçë, Maliq, Kukës, Lezhë, Malësi e Madhe, Shkodër, Vau i Dejës dhe Tiranë.

Gjithashtu, konstatohet një njësi si Dropulli e cila këtë format ka bërë përpjekje për ta plotësuar sipas udhëzimeve por e ka realizuar pjesërisht, pra në mënyrë jo të plotë pra pjesërisht.

Pjesa tjetër prej 39 e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore ose 64% e bashkive gjithsej, nuk e kanë plotësuar kërkesën për paraqitjen e treguesve financiarë të realizimit të buxhetit vendor në vitin 2019. Bashkitë të cilat nuk e kanë realizuar këtë kërkesë janë Poliçan, Ura Vajgurore, Klos, Mat, Krujë, Shijak, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Përrenjas, Mallakastër, Roskovec, Gjirokastrë, Këlcyrë, Libohovë, Memaliaj, Përmet, Tepelenë, Devoll, Pogradec, Pustec, Has, Tropojë, Kurbin, Mirditë, Fushë-Arrëz, Pukë, Kamëz, Kavajë, Rogozhinë, Vorë, Delvinë, Finiq, Himarë, Konispol, Sarandë, Selenicë dhe Vlorë.

### **Si ka ndryshuar situata e plotësimit të këtij treguesi gjatë viti 2019 në raport me një vit më parë?**




Një tjetër tregues i rëndësishëm në analizën e performancës së realizimit të raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit vendor është krahasimi i njësive të cilat kanë përmirësuar raportin në vitin 2019 krahasuar me atë të një viti më parë duke e paraqitur këtë format.

Duke marrë në analizë njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit 2018 nuk e kanë paraqitur formatin e treguesve financiarë por që kanë përmirësuar situatën duke e paraqitur atë në vitin 2019, janë 14 bashki ose 22% e bashkive gjithsej, si bashkia: Berat, Kuçovë, Bulqizë, Dibër, Durrës, Cërrik, Divjakë, Fier, Lushnje, Patos, Dropull, Malësi e Madhe, Vau i Dejës dhe Tiranë. Në tërësi vlen shumë të vlerësohet fakti që një pjesë e konsiderueshme e bashkive kanë ardhur në përmirësim në plotësimin e këtij formati nga një vit më parë.

Gjithashtu, ekzistojnë dhe njësi të vetëqeverisjes vendore që për arsye të ndryshme, në krahasim me raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2018, në vitin 2019 nuk e kanë paraqitur formatin e treguesve financiarë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë bërë regres në hartimin e këtij formati duke mos e paraqitur atë janë njësia Shijak, Gjirokastrë, Tropojë dhe Vlorë.

Nga ana tjetër, ekzistojnë 43 bashki ose 65.5% e njësive gjithsej të cilat kanë ruajtur të njëjtin standard në vitin 2019 në raport me një vit më parë, lidhur me plotësimin ose jo të formatit të treguesve financiarë në raportin vjetor të zbatimit të buxhetit. Bashkitë të cilat kanë ruajtur të njëjtin standard duke e plotësuar këtë format si në vitin 2018 ashtu edhe në vitin 2019 janë bashkitë Skrapar, Belsh, Kolonjë, Korçë, Maliq, Kukës, Lezhë dhe Shkodër. Ndërkohë që bashkitë të cilat vazhdojnë të ruajnë të njëjtin trend negativ duke mos e plotësuar këtë format si në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit 2018 ashtu edhe në 2019 janë njësitë Poliçan, Ura Vajgurore, Klos, Mat, Krujë, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Përrenjas, Mallakastër, Roskovec, Këlcyrë, Libohovë, Memaliaj, Përmet, Tepelenë, Devoll, Pogradec, Pustec, Has, Kurbin, Mirditë, Fushë Arrëz, Pukë, Kamëz, Kavajë, Rogozhinë, Vorë, Delvinë, Finiq, Himarë, Konispol, Sarandë dhe Selenicë.

Harta 7: Raportimi i treguesve financiarë të vitit 2019



---

## 8. Të ardhurat sipas burimit

Nga analiza e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2019, evidentohet se 35 bashki ose 57% kanë plotësuar raportin e realizimit të të ardhurave sipas burimit. Njësitë të cilat e kanë plotësuar këtë raport janë Bashkia Berat, Kuçovë, Ura Vajgurore, Bulqizë, Dibër, Mat, Durrës, Shijak, Cërrik, Elbasan, Librazhd, Përrenjas, Divjakë, Fier, Lushnje, Patos, Roskovec, Dropull, Gjirokastër, Këlcyrë, Libohovë, Përmet, Kolonjë, Korçë, Maliq, Kurbin, Fushë Arrëz, Malësi e Madhe, Shkodër, Vau i Dejës, Kamëz, Tiranë, Delvinë, Sarandë dhe Vlorë.

Gjithashtu evidentohen 2 njësi të vetëqeverisjes vendore që formatin e të ardhurave sipas burimit e kanë plotësuar pjesërisht si Bashkia Klos dhe Krujë. Të dyja këto njësi janë konsideruar pjesërisht për shkak se në raport është paraqitur informacion vetëm mbi nivelin e realizimit të të ardhurave të veta vendore por pa e specifikuar këtë burim sipas zërave të të ardhurave.

Nga ana tjetër janë 24 bashki ose 39.3% e njërive gjithsej që nuk e kanë plotësuar formatin e të ardhurave sipas burimeve. Njësitë të cilat nuk e kanë plotësuar këtë format janë Poliçan, Skrapar, Belsh, Gramsh, Peqin, Mallakastër, Memaliaj, Tepelenë, Devoll, Pogradec, Pustec, Has, Kukës, Tropojë, Lezhë, Mirditë, Pukë, Kavajë, Rrogozhinë, Vorë, Finiq, Himarë, Konispol dhe Selenicë.

### **Si ka ndryshuar situata e plotësimit të këtij treguesi gjatë vitit 2019 në raport me një vit më parë?**




Duke marrë në analizë njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit 2018 nuk e kanë paraqitur formatin të ardhurave sipas burimit por që kanë përmirësuar situatën duke e paraqitur atë në vitin 2019 janë 13 bashki ose 21% e bashkive gjithsej, si bashkia Shijak, Përrenjas, Patos,

Roskovec, Dropull, Këlcyrë, Libohovë, Përmet, Kolonjë, Maliq, Malësi e Madhe, Delvinë dhe Sarandë. Në tërësi vlen shumë të vlerësohet fakti që një pjesë e konsiderueshme e bashkive kanë përmirësuar në plotësimin e këtij formati në raport me një vit më parë.

Gjithashtu, ekzistojnë njësi të vetëqeverisjes vendore që për arsye të ndryshme në krahasim me raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2018, në vitin 2019 nuk e kanë paraqitur formatin e të ardhurave të veta vendore sipas burimit. Njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë bërë regres në hartimin e këtij formati duke mos e paraqitur atë janë 12 bashki ose 20% e bashkive gjithsej. Bashkitë të cilat kanë bërë një regres të plotë duke mos e paraqitur këtë format në vitin 2019 janë bashkitë: Mallakastër, Memaliaj, Pogradec, Has, Lezhë, Mirditë, Pukë, Rrogozhinë dhe Vorë. Gjithashtu, 2 bashki si Skrapari dhe Himara kanë bërë regres ku nga një plotësim pjesor i këtij formati në vitin 2018, nuk e kanë plotësuar atë në vitin 2019 dhe 1 bashki si Klosi të cilat nga një format i plotësuar në vitin 2018 e kanë plotësuar pjesërisht në vitin 2019.

Nga ana tjetër, ekzistojnë bashki 36 bashki ose 59% e njërive gjithsej të cilat kanë ruajtur të njëjtin standard në vitin 2019 në raport me një vit më parë lidhur me plotësimin ose jo të formatit të të ardhurave të veta vendore sipas burimit në raportin vjetor të zbatimit të buxhetit. Bashkitë të cilat kanë ruajtur të njëjtin standard duke e plotësuar këtë format si në vitin 2018 ashtu edhe në vitin 2019 janë bashkitë Berat, Kuçovë, Ura Vajgurore, Bulqizë, Dibër, Mat, Durrës, Cërrik, Elbasan, Librazhd, Divjakë, Fier, Lushnje, Gjirokastër, Korçë, Kurbin, Fushë Arrëz, Shkodër, Vau i Dejës, Kamëz, Krujë, Tiranë dhe Vlorë. Ndërkohë që bashkitë të cilat vazhdojnë të ruajnë të njëjtin trend negativ duke mos e plotësuar këtë format si në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit 2018 ashtu edhe në atë të vitit 2019 janë bashkitë: Poliçan, Belsh, Gramsh, Peqin, Tepelenë, Devoll, Pustec, Kukës, Tropojë, Kavajë, Finiq, Konispol dhe Selenicë.

Harta 8: Raportimi i të ardhurave sipas burimit në vitin 2019





---

## 9. Raportimi i të ardhurave sipas burimit: të ardhura të planifikuara kundrejt atyre faktike

### Si ka ndryshuar situata e plotësimit të këtij treguesi gjatë vitit 2019 në raport me një vit më parë?

Nga analiza e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit vendor 2019, në 61 bashki vetëm 34 bashki ose 55.7% e kanë paraqitur formatin e detajuar të planit dhe realizimit faktik të të ardhurave sipas burimit. Këto njësi të vetëqeverisjes vendore që kanë plotësuar formatin e kërkuar janë Bashkia Berat, Kuçovë, Ura Vajgurore, Bulqizë, Dibër, Klos, Mat, Durrës, Shijak, Cërrik, Elbasan, Librazhd, Divjakë, Fier, Lushnje, Patos, Roskovec, Dropull, Gjirokastrë, Këlcyrë, Libohovë, Përmet, Kolonjë, Korçë, Maliq, Kurbin, Malësi e Madhe, Shkodër, Vau i Dejës, Kamëz, Tiranë, Delvinë, Sarandë dhe Vlorë.

Ndërkohë që ekzistojnë dhe 3 bashki ose rreth 5% e bashkive gjithsej që kanë plotësuar pjesërisht formatin lidhur me planin dhe faktin e të ardhurave të veta vendore. Bashkitë të cilat e kanë plotësuar pjesërisht këtë format janë Kruja, Fushë Arrëzi dhe Selenica, ku konstatohet se bashkia Krujë ka paraqitur informacion vetëm mbi masën e realizimit të të ardhurave por pa specifikuar sipas zërave dhe bashkia Selenicë e cila ka paraqitur informacion vetëm për totalin e të ardhurave.

Gjithashtu, në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit 2019 këtë raport nuk e kanë plotësuar 24 bashki ose 39.3% e bashkive gjithsej. Bashkitë të cilat nuk e kanë plotësuar këtë format janë bashkia Poliçan, Skrapar, Belsh, Gramsh, Peqin, Përrenjas, Mallakastër, Memaliaj, Tepelenë, Devoll, Pogradec, Pustec, Has, Kukës, Tropojë, Lezhë, Mirditë, Pukë, Kavajë, Rrogozhinë, Vorë, Finiq, Himarë dhe Konispol.




Krahasimi i ecurisë së të njëjtit standard të plotësimit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore është një pjesë e rëndësishme e këtij raporti. Në këtë seksion do të marrim në analizë nëse në pjesë të raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit 2019, është ruajtur i njëjti standard, përmirësuar, apo përkeqësuar me raportimin e vitit 2018 lidhur me formatin e të ardhurave të planifikuara dhe realizimin faktik sipas burimit. Duke marrë në analizë njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit 2018 nuk e kanë paraqitur formatin të ardhurave sipas burimit me planin dhe faktin por që e kanë përmirësuar situatën duke e paraqitur atë në vitin 2019 janë 12 bashki ose 19.6% e bashkive gjithsej, të tilla si bashkia Dibër, Shijak, Fier, Patos, Roskovec, Dropull, Këlcyrë, Libohovë, Kolonjë, Maliq, Fushë Arrëz dhe Selenicë. Në tërësi vlen shumë të theksohet fakti që një pjesë e konsiderueshme e bashkive kanë përmirësim në plotësimin e këtij formati në raport me një vit më parë.

Gjithashtu, ekzistojnë njësi të vetëqeverisjes vendore që për arsye të ndryshme në krahasim me raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2018, në vitin 2019 nuk e kanë paraqitur formatin e të ardhurave të veta vendore sipas burimit në plan dhe fakt. Njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë bërë regres në hartimin e këtij formati duke mos e paraqitur atë janë vetëm 7 bashki ose 11.4% e bashkive gjithsej. Nga këto bashki kanë bërë regres duke mos e paraqitur këtë format në vitin 2019, në raport me një vit më parë bashkitë Skrapar, Krujë, Mallakastër, Memaliaj, Pogradec, Lezhë dhe Himarë. Ndërkohë vetëm bashkia Krujë ka bërë regres duke e paraqitur pjesërisht këtë raport në vitin 2019 ndërkohë që është plotësuar saktësisht në vitin 2018.

Nga ana tjetër, ekzistojnë bashki 42 bashki ose 70.5% e njërive gjithsej të cilat kanë ruajtur të njëjtin standard në vitin 2019 në raport me një vit më parë lidhur me plotësimin ose jo të formatit të të ardhurave të veta vendore sipas



Harta 9: Raportimi i të ardhurave të planifikuara kundrejt atyre të realizuara në vitin 2019



burimit në plan dhe fakt në raportin vjetor të zbatimit të buxhetit. Bashkitë të cilat kanë ruajtur të njëjtin standard duke e plotësuar këtë format si në vitin 2018 ashtu edhe në vitin 2019 janë bashkitë Berat, Kuçovë, Ura Vajgurore, Bulqizë, Klos, Mat, Durrës, Cërrik, Elbasan, Librazhd, Divjakë, Lushnje, Gjirokastër, Përmet, Korçë, Kurbin, Malësi e Madhe, Shkodër, Vau i Dejës, Kamëz, Tiranë, Delvinë, Sarandë dhe Vlorë. Ndërkohë që bashkitë të cilat vazhdojnë të ruajnë të njëjtin trend negativ duke mos e plotësuar këtë format si në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit 2018 ashtu edhe në 2019 janë njësitë si Poliçan, Belsh, Gramsh, Peqin, Përrenjas, Tepelenë, Devoll, Pustec, Has, Kukës, Tropojë, Mirditë, Pukë, Kavajë, Rrogozhinë, Vorë, Finiq dhe Konispol.


## 10. Përdorimi i raportit nga Këshilli Bashkiak

Ky është një nga kriteret e reja që futet në raport. Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit prodhohet nga NJVQV-ja si një kërkesë ligjore e trajtuar në nenin 48, 51 të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" dhe detajuar sipas udhëzimit standard për monitorimin e buxhetit vendor.

Referuar standardit ligjor, në këtë raport trajtohet për herë të parë plotësimi i kësaj kërkesë për trajtimin në këshill bashkiak nga njësitë e vetëqeverisjes vendore

Ashtu siç mund të shikohet në hartë, 37 bashki ose 61 për qind e kanë diskutuar apo miratuar RMZB-në në Këshillin Bashkiak, ndërsa 23 bashki ose 38 për qind nuk e kanë prezantuar raportin në këshill bashkiak.

Harta 10: Përdorimi i raportit në Këshillat Bashkiakë 2019



---

## 11. Transparenca ndaj komunitetit

Ky është një tjetër kriter i cili trajtohet në raport për herë të parë, por që përben një kërkesë ligjore të trajtuar në Ligjin e Financave Vendore si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të NJVQV-ve".

Publikimi në Internet i raportit vjetor mundëson transparencë ndaj komunitetit por njëkohësisht i mundëson atij të njihet me zbatimin e buxhetit në mënyrë të detajuar dhe të bazojë kërkesat e veta në fakte të prodhuara dhe të miratuara nga bashkia.

Sikurse duket nga harta vetëm 27 bashki nga 61 e kanë publikuar raportin në Internet kurse pjesa tjetër e bashkive nuk e kanë vendosur RZMB-në në faqen e internetit të bashkisë. Për më shumë hollësi referojuni hartës 11.


## 12. Renditja e bashkive për përputhshmërinë në lidhje me kriteret

Vlerësimi me pikë për secilën bashki është bërë në përputhje me përfundimet nëse NJVQV-të i kanë plotësuar kriteret plotësisht, pjesërisht ose aspak. Mbështetur mbi këtë përcaktim është pikëzuar secila njësi ku maksimumi është 11 pikë (11 kriteret) dhe minimumi 0 pikë.

Harta e mëposhtme tregon 4 kategori: Bashkitë me ngjyrë të gjelbër të errët kanë përputhshmëri të lartë dhe janë vlerësuar me 8.5 deri 11 pikë. Bashkitë me ngjyrë të gjelbër të lehtë kanë përputhshmëri mbi mesataren duke marrë 6 deri 8.4 pikë nga 11 të mundshme. Bashkitë me ngjyrë gri që kanë marrë 3.5 deri 5 pikë janë në segmentin mesatar ndërkohë që bashkitë e ngjyrosura me të kuqe nuk i kanë plotësuar kërkesat në lidhje me raportimin.

Nga 61 bashki, 24 prej tyre kanë raportuar duke plotësuar shumicën e kriterëve, pra kanë përputhshmëri të lartë, 18 bashki kanë përputhshmëri mbi mesataren, 11 bashki kanë përputhshmëri mesatare dhe 8 bashki nuk i kanë plotësuar kriteret.

Harta 11: Vendosja e RMZB-së 2019 në web



Bashkitë të cilat plotësojnë shumicën e kritereve të raportimit sipas kërkesave janë bashkitë Bulqizë, Korçë, Shkodër, Dropull, Dibër, Durrës, Fier, Libohovë, Berat, Patos, Përmet, Maliq, Malësi e Madhe, Tiranë, Elbasan, Gjirokastrë, Kolonjë, Delvinë, Mat, Cërrik, Lushnje, Fushë Arrëz dhe Kamëz.

Në krahasim me një vit më parë renditja ka një përmirësim të dukshëm ku nga 3 bashki me përputhshmëri të lartë në vitin 2018, në

vitin 2019 rezultojnë 24, nga 27 bashki me notë mbi mesatare në 2018 kemi vetëm 20 në vitin 2019, nga 18 bashki me notë mesatare kemi vetëm 9 bashki në vitin 2019 duke qenë se ato kanë lëvizur në pikëzim duke kapur një kategori më lart.

Tabela 7 tregon rezultatet e bashkive me notën më të lartë të përputhshmërisë me kërkesat e udhëzimit.

Tabela 7: Grupi i bashkive me përputhshmëri më të lartë me kërkesat e udhëzimit (8.5 deri 11 pikë)

<b>Shkodër</b>	11	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO
<b>Korçë</b>	11	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO
<b>Bulqizë</b>	11	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO
<b>Dropull</b>	10.5	PO	PO	PJESËRISHT	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO
<b>Libohovë</b>	10	PO	PO	PO	PO	JO	PO	PO	PO	PO	PO	PO
<b>Fier</b>	10	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	JO
<b>Durrës</b>	10	PO	PO	PO	PO	PO	PO	JO	PO	PO	PO	PO
<b>Dibër</b>	10	PO	PO	JO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO
<b>Tiranë</b>	9.5	PO	PO	PJESËRISHT	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	JO
<b>Malësi e Madhe</b>	9.5	PO	PO	PJESËRISHT	PO	PO	PO	JO	PO	PO	PO	PO
<b>Maliq</b>	9.5	PO	PO	PJESËRISHT	PO	PO	PO	PO	PO	PO	JO	PO
<b>Përmet</b>	9.5	PO	PO	PJESËRISHT	PO	JO	PO	PO	PO	PO	PO	PO
<b>Patos</b>	9.5	PO	PO	PJESËRISHT	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	JO
<b>Berat</b>	9.5	PO	PO	PJESËRISHT	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	JO
<b>Delvinë</b>	9	PO	PO	PJESËRISHT	PO	JO	PO	PJESËRISHT	PO	PO	PO	PO
<b>Lezhë</b>	9	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	JO	JO	PO	PO
<b>Kolonjë</b>	9	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO	JO	JO
<b>Gjirokastrë</b>	9	PO	PO	PO	PO	JO	PO	PO	PO	PO	PO	JO
<b>Elbasan</b>	9	PO	PO	PO	PO	JO	PO	PO	PO	PO	PO	JO
<b>Kamëz</b>	8.5	PO	PO	PJESËRISHT	PO	JO	PO	JO	PO	PO	PO	PO
<b>Fushë Arrëz</b>	8.5	PO	PO	PO	PO	JO	PO	JO	PO	PJESËRISHT	PO	PO
<b>Lushnje</b>	8.5	PO	PO	PJESËRISHT	PO	PO	PO	JO	PO	PO	PO	JO
<b>Cërrik</b>	8.5	PO	PO	PJESËRISHT	PO	PO	PO	PO	PO	PO	JO	JO
<b>Mat</b>	8.5	PO	PO	PJESËRISHT	PO	JO	PO	JO	PO	PO	PO	PO
	0 5 11 Pikët në total	Përgatitja e një raporti	Shpenzimet sipas programit (Aneksi 1)	Programe të njëjta në RMZB 19 & PBA 19-21	Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik	Treguesit financiar	Lista e projekteve të investimit	Elementët e Performancës	Të ardhurat sipas burimit	Të ardhurat e planifikuara dhe të realizuara	Raportimi në Këshill	Transparenca



Po = 1 e barabartë me 1 pikë





Jo = 2 e barabartë me 0 pikë



Pjesërisht = 3 e barabartë me 0.5 pikë

Harta 12: Renditja e përputhshmërisë së RMZB-së në vitin 2019 me kuadrin ligjor



**LEGJENDA**

24	▲	Përputhshmëri e lartë (8.5 - 11 pikë)
20	▲	Mbi mesatare (6 - 8.4 pikë)
9	■	Mesatare (3.5 - 5.9 pikë)
0	▲	Nën mesatare (1 - 3.4 pikë)
8	▲	Nuk ka përputhshmëri (0 pikë)

---

# 4. Rekomandime

---

Monitorimi është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ata të planifikuar. Menaxhimi i shpenzimeve vendore është i rëndësishëm me qëllim realizimin e produkteve të parashikuara, brenda kufirit të miratuar të shpenzimeve për çdo program. Nëpërmjet monitorimit të zbatimit të buxhetit është e rëndësishme që të sigurohet informacion i plotë në lidhje me performancën e shpenzimeve dhe realizimin e produkteve. Monitorimi i objektivave realizohet bazuar në treguesit përkatës të performancës që jepen kryesisht në nivel produkti, ndërsa monitorimi i produkteve realizohet në sasi dhe në vlerë. Monitorimi është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka punuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2019 në funksion të përmirësimit të raporteve të monitorimit.

Për shumë nga treguesit e marrë në analizë në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit 2019, krahasuar me atë në një vit më parë ka përmirësim të ndjeshëm në shumicën e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Pavarësisht rekomandimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në raportin e përputhshmërisë së vitit të kaluar, procesi i monitorimit vazhdon të ketë problematika në drejtim të standardizimit të formatit dhe informacionit që duhet të përmbajë RMZB-ja, përmirësimit të informacionit financiar dhe cilësor, përmirësimit të analizës dhe argumenteve të paraqitura për realizimin e çdo programi buxhetor, si dhe plotësimit të të gjitha anekseve në përputhje me udhëzimin standard të monitorimit.

Një prej rekomandimeve të vitit të kaluar lidhet me plotësimin e aneksit për treguesit e performancës, për të cilin Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të punojë në vazhdimësi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për ta përmirësuar dhe plotësuar si kërkesë ligjore, por mbi të gjitha për të ndihmuar bashkitë në përdorimin e informacionit që paraqet ky tregues.

## 1. Nga Ministria e Financave dhe

**Ekonomisë** është konstatuar se nga disa bashki raporti i monitorimit paraqitet pa bërë një analizë të faktorëve të cilët kanë ndikuar negativisht në realizimin e shpenzimeve të planifikuara sipas programeve. Kjo analizë është e rëndësishme duke përmirësuar edhe procesin e planifikimit në vitin e ardhshëm buxhetor.

### *Rekomandim:*

- Të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të paraqesin të plotë raportin e monitorimit duke përfshirë edhe një analizë të hollësishme të shkaqeve që kanë sjellë mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara sipas programeve. Monitorimi duhet të përmbajë edhe argumentet përkatëse të bashkisë lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar në nivel programi dhe zëri.

## 2. Mungon informacioni mbi treguesit

**financiarë** sipas përcaktimeve të nenit 54, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", si kërkesë ligjore e udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, të monitorimit.



#### *Rekomandim:*

- Paraqitja në raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit të treguesve financiarë të cilët janë të rëndësishëm për të vlerësuar qëndrueshmërinë financiare të njësisë vendore, si dhe sigurojnë informacion mbi burimet financiare në dispozicion. Gjithashtu, sigurohet informacion mbi mënyrën e përdorimit të fondeve publike të njësisë vendore, raportin e financimit të NJVQV-së me transfertat apo të ardhurat e veta, disiplinën fiskale, si dhe informacion nëse njësia është e ekspozuar ndaj rreziqeve fiskale.

**3. Në raportin e monitorimit** nuk paraqitet raporti i objektivave të synuara dhe treguesit e performancës për çdo program, si një pjesë shumë e rëndësishme për të evidentuar produktet dhe më pas të vijohet drejt objektivit kryesor- kostimit të tyre.

#### *Rekomandim:*

- Për të gjitha programet duhet të plotësohen të dhënat mbi realizimin e treguesve të performancës/ produkteve, të paraqitura sipas aneksit nr.4 "Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit", të përcaktuar në udhëzimin standard të monitorimit, si dhe është e rëndësishme plotësimi i komenteve për secilin tregues për të evidentuar arritjet si edhe problematikat. Bashkia duhet t'i përdorë këta tregues për të përcaktuar fushat prioritare për ofrimin e shërbimeve për vitet në vazhdim.

**4. Në raportin e monitorimit** nuk paraqitet informacion për detyrimet e prapambetura.

#### *Rekomandim:*

- Një ndër problematikat që duhet të trajtohet nga njësiti e vetëqeverisjes vendore në raportet e monitorimit është edhe evidentimi dhe trajtimi

i detyrimeve të prapambetura, si për ato të trashëguara ashtu edhe për ato të krijuara rishtazi. Raporti i monitorimit duhet të përmbajë një informacion përmbledhës për detyrimet e prapambetura, paraqitjen e argumenteve lidhur me krijimin e tyre, arsyet e mosshlyerjes së detyrimit të mbetur në fund të vitit si dhe një analizë të planit të veprimit për shlyerjen e tyre.

**5. Relacioni shpjegues** nuk përmban një informacion të hollësishëm për të gjithë procesin e monitorimit, duke pasqyruar probleme në cilësinë e të dhënave që paraqiten dhe analizohen.

#### *Rekomandim:*

- Relacioni duhet të përmbajë një analizë shumë të hollësishme të realizimit të shpenzimeve sipas programeve, si dhe realizimin e të ardhurave sipas burimeve të financimit. Analiza duhet të jetë e saktë në formë përshkruese, tabelare dhe grafike. Në raportin e monitorimit duhet të paraqitet një informacion i hollësishëm mbi procesin e monitorimit, ecurinë e realizimit të qëllimit dhe objektivave për çdo program.

**6. Në raportin e monitorimit** programet e paraqitura në disa njësi të vetëqeverisjes vendore nuk janë në përputhje të plotë me programet në Programin Buxhetor Afatmesëm.

#### *Rekomandim:*

- Planifikimi dhe më pas ekzekutimi i buxhetit janë dy procese që lidhen ngushtë me njëri-tjetrin. Si rrjedhojë është shumë e rëndësishme që si në fazën e planifikimit dhe më pas në ekzekutim të mos ketë ndryshime në listën e programeve buxhetore të përdorura nga njësiti e vetëqeverisjes vendore.



